



PhD Gazmend Zeneli

Pedagog në Departamentin e
Turizmit, Mikpritjes dhe
Rekreacionit

BIOGRAFIA

Dr. Gazmend Zeneli ka rreth 30 vite përvojë në fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies universitare dhe projekteve zhvillimore. Ai ka përfunduar studimet pasuniversitare në Mediterranean Agronomic Institute of Chania (Greqi), ku ka marrë gradën Master i Shkencave (M.Sc.) në Shkencat e Mjedisit. Më pas, ai ka fituar gradën Doktor i Shkencave (Dr. rer. nat.) nga Universiteti Friedrich Schiller në Jena (Gjermani), pas disa viteve të punës kërkimore pranë Max Planck Institute for Chemical Ecology, gjithashtu në Jena.

Gjatë karrierës së tij akademike dhe shkencore, Dr. Zeneli është angazhuar në disa nga institutet dhe universitetet ndërkombëtare më të njohura, përfshirë Max Planck Institute for Chemical Ecology, Technical University of Dresden dhe Leibniz Institute of Ecological Regional Development. Ai është fitues i disa granteve ndërkombëtare për kërkime shkencore dhe autor i mbi 30 artikujve shkencorë, të publikuar në revista të njohura ndërkombëtare në fushën e mjedisit dhe shkencave natyrore. Punimet e tij janë cituar mbi 750 herë dhe ai ka një H-index prej 8. Rezultatet e kërkimeve të tij janë prezantuar në më shumë se 45 konferenca shkencore ndërkombëtare.

Dr. Zeneli ka një përvojë të konsoliduar në menaxhimin akademik dhe kërkimor, duke mbajtur pozita të rëndësishme si Drejtor i Institutit për Kërkim dhe Zhvillim "Barleti", Dekan Fakulteti, Drejtues Departamenti, si dhe Koordinator dhe Menaxher i projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prej më shumë se 15 vitesh, ai është i angazhuar në jetën akademike si pedagog universitar, ku ligjëron disa lëndë në programet Bachelor dhe Master pranë Universitetit "Barleti" në Tiranë. Dr. Zeneli flet rrjedhshëm anglisht dhe gjermanisht, dhe është lektor i ftuar në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë (Republika e Maqedonisë së Veriut), si dhe në University of Arkansas – Clinton School of Public Service (SHBA).